



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZL.Anr.72/2025

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Ramush Bardiqi - kryesues, Hidajete Gashi Alaj dhe Kujtim Pasuli - anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, të paraqitur kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë Fushatës Zgjedhore për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur më 29.09.2025, merr këtë:

V E N D I M

Refuzohet e pa bazuar ankesa e subjektit politik, Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, ZL.Anr.72/2025, e datës 27.09.2025, paraqitur kundër subjektit Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë Fushatës Zgjedhore Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës.

A r s y e t i m

Me datë 27.09.2025, PZAP-i ka pranuar një ankesë nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me të cilën pretendon se më datë 26.09.2025, aktivistet e qendrës së Lëvizjes Vetëvendosje kanë vërejtur se kandidati i subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës – Përparim Rama në faqen personale të tij në facebook ka publikuar dhe shpërndarë fragment të shpërndarë nga intervista e tij në televizionin Klan Kosova ku mes të tjerash deklaroi se *“e dim si ka ardhur partia e tij në pushtet me mollotova me gjuajtje gurësh etj, është gënjeshtar patologjik”*, ndërsa në përshkrimin e videos në facebook shkruan se :*“Kjo video dëshmon se Hjarullah Çeku është gënjeshtar patologjik”*. Në ankesë theksohet se me veprimet e sipërpërmendura ka shkelur dispozitat e nenit 34 të LZP-ë duke përdorur gjuhë denigruese që mund të nxisin akte dhune kundër kundërshtarëve politik. Si provë kanë bashkëngjitur video linkun në facebook.

Në përgjigje në ankesë kanë theksuar se i kundërshtojnë në tërësi pretendimet e thëna në ankesë. Tutje kanë shtuar se videoja e përmendur nga pala ankuese i referohet një interviste të Kryetarit të Komunës, e realizuar pas një seance të Kuvendit Komunal, ku është pyetur për

një incident fizik që kishte ndodhur menjëherë pas seancës në oborrin e Komunës së Prishtinës ndaj një assembleisti të LDK-së dhe Kryesuesit të Kuvendit. Kanë theksuar se kjo video nuk ka qene aktivitet zgjedhor i planifikuar, nuk është organizuar nga LDK-ja dhe nuk ka pasur qëllim apo elemente të fushatës elektorale. Tutje kanë shuar se nuk ka përdorur gjuhë që nxit dhunë, urrejtje ose diskriminim, duke shtuar se nuk ka pasur akt të organizuar për promovim politik, as shpërndarje materiale, bëhet fjalë për një incident të izoluar që ndodhi në hapësirat publike të Komunës dhe për të cilin tashmë po merren organet kompetente të rendit. Kanë kërkuar që ankesa e subjektit politik LVV të refuzohet si e pabazuar.

Paneli pasi që shqyrtoj ankesën vlerësoi se:

-Ankesa është e pabazuar.

Paneli pas shikimit të shkresave të lëndës dhe përgjigjes në ankesë të paraqitur nga subjekti politik, Lidhja Demokratike e Kosovës, vlerësoj se pretendimet e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj për faktin se veprimet e përshkruara në ankesë nuk paraqesin shkelje të dispozitës së nenit 34 paragrafi 1 nën paragrafi 1.11, të LZP-së, Nr.08/L-228 me të cilën përcaktohet: *"Gjatë periudhës së fushatës, subjekti politik, mbështetësit ose kandidatët e tij, ndalohen nga bërja e ndonjëres si në vijim: përdorimi i gjuhës, në formën e shkruar ose gojore, që nxit ose provokon, ose që mund të nxisë ose provokojë, një person tjetër për të kryer një akt të dhunës kundër personave tjerë ose pasurisë, ose e cila nxit apo mund të nxisë urrejtje kundrejt të tjerëve ose duke publikuar ose përdorur fotografi, simbole ose çfarëdo materiali tjetër që ka ose mund të ketë ndikim të tillë".*

Pretendimet ankimore të parashtruesit të ankesës lidhur me shkeljen e pretenduar nga ana e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës, Paneli i vlerësoj se janë të pabazuara dhe nuk janë bindëse, për faktin se veprimet e përshkruara në ankesë nuk paraqesin ndonjë nga shkeljet e pretenduara, kjo pasi që në intervistën e dhënë në Klan Kosova, kandidati nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës se: *"e dim si ka ardhur partia e tij në pushtet me mollotova me gjuajtje gurësh etj, është gënjeshtar patologjik"* sipas vlerësimit të Panelit, kjo deklaratë nuk është në kundërshtim me Kodin e Mirësjelljes për Subjekte Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, përkatësisht me dispozitat nenit 34 par 1 pika 1.11 të LZP-së. Deklarata e thënë në emisionin televiziv nuk përmban fjalor që nxit apo provokon, ose që mund të nxisë një person tjetër për të kryer akt të dhunës kundër personave tjerë. Për më tej, Paneli arsyeton se fjalia e përdorur në rastin konkret nuk mund të konsiderohet si fjale që nxite dhunë ose urrejtje dhe nuk bie në kuadër bazave të mbrojtura, siç janë (etni, race, fe, gjini etj). Gjuhë e urrejtjeje në jurisprudencën e gjykatës Strasburgut zakonisht nënkupton shprehje që përfshihet me të urrejtur, diskriminim, armiqësi ose dhunë kundër individëve ose grupeve të identifikueshme të popullsisë për arsye të karakteristikave të tyre (race, fe, orientim seksual, etj.).

Paneli me rastin e shikimit të shkresave të lëndës, vlerësoi se ankesa është e pabazuar pasi që nga provat e ofruara të cilat parashtruesi i ankesës i ka bashkangjitur si dëshmi, nuk mund të vërtetohet se është kryer shkelja e pretenduar për të cilën referohet pala ankuese andaj pretendimet e tilla nuk mund të merren si të bazuara.

Duke marrë parasysh të lartpërmendurat, Paneli vlerëson se parashtruesi i ankesës në mbështetje të pretendimeve të tij, nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse, edhe pse në bazë të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në të cilin nen në mënyrë decitive thuhet se *“Vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse”*.

Nga arsyet e theksuara më lartë dhe duke u bazuar nënin 117 par. 3, lidhur me nenin 118 pa. 1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës
ZL.Anr.72/2025 datë 29.09.2025

Kryesues i Panelit
Ramush Bardhi



Këshillë Juridike: *Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykata Supreme të Kosovë, brenda 48 orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.*